



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 1539/prot.  
8

Tiranë, më 25/04/2020

URDHËR

Nr. 278, datë 25.04.2020

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË URDHËRIN NR. 193 DATË  
20.03.2020 “PËR MBYLLJEN APO KUFIZIMIN E LËVIZJEVE NË RE-  
PUBLIKËN E SHQIPËRISË” TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 7, pika 4, dhe 15, të ligjit nr.15/2016,“Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

**U R D H Ë R O J:**

Në Urdhrin nr.193 datë 20.03.2020 “Për kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime si vijon:

1. Në pikën 1/1 togfjalëshi “afat prej 90 minutash” zëvendësohet me togfjalëshin “afat prej 2 (dy) orësh”.
2. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me përmbajtje si vijon:

“3/1.Lejohen të ushtrojnë veprimtarinë e tyre, bizneset e mbyllura sipas listës bashkëlidhur Urdhrit nr. 193 datë 20.03.2020 “Për kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, të kategorizuara me risk të ulët sipas listës bashkëlidhur këtij urdhëri, duke filluar nga dita e hënë, datë 27.04.2020, e në vijim, në intervalin kohor prej orës 5:00 deri në orën 17:30. Këto aktivitete do të ushtrojnë veprimtarinë vetëm në bazë të protokolleve të miratuara në urdhrin nr. 266 datë 21.04.2020 “Për përcaktimin e kategorieve

të bizneseve sipas niveleve të riskut dhe miratimit të protokolleve të masave higjieno-sanitare dhe distancimit social për parandalimin e përhapjes së COVID-19”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**Ogerta Manastirliu**



<b>Statusi</b>	<b>Klasa</b>	<b>Klasa_Përshkrimi</b>
Lejohen	4719	Shitje të tjera me pakicë në dyqane jo të specializuara
Lejohen	4771	Tregtia me pakicë e veshjeve në dyqane të specializuara
Lejohen	4778	Shitje me pakicë të mallrave të tjera të reja në dyqane të specializuara
Lejohen	4932	Aktiviteti i taksive
Lejohen	4751	Tregtia me pakicë e tekstileve në dyqane të specializuara
Lejohen	4772	Tregtia me pakicë e këpucëve dhe artikujve prej lëkure në dyqane të specializuara
Lejohen	9609	Aktivitete te tjera p.k.t
Lejohen	4759	Tregtia me pakicë e mobiljeve, pajisjeve të ndriçimit dhe artikujve shtëpiakë në dyqane të special izuara p.k.t
Lejohen	4776	Tregtia me pakicë e luleve, bimëve, farave, plehëruesve, kafshëve të shtëpisë dhe ushqimit të tyre në dyqane të specializuara
Lejohen	4777	Tregtia me pakicë e orëve dhe bizhuterive në dyqane të specializuara
Lejohen	4743	Tregtia me pakicë e pajisjeve audio dhe video në dyqane të specializuar
Lejohen	5920	Regjistrimi i zërit dhe aktivitete të publikimit të muzikës
Lejohen	4753	Tregtia me pakicë e qylymave, sixhadeve, veshjeve të mureve dhe dyshemeve në dyqane të specializuara
Lejohen	4765	Tregtia me pakicë e lojrave dhe lodrave në dyqane të specializuara
Lejohen	4763	Tregtia me pakicë e regjistruessve muzikorë dhe video në dyqane të specializuara
Lejohen	4764	Tregtia me pakicë e pajisjeve sportive në dyqane të specializuara
Lejohen	4742	Tregtia me pakicë e pajisjeve të telekomunikacionit në dyqane të specializuar/ Pajisjet e telekomunikacionit ne dyqane të specializuara